

VENDIM
Nr.393, datë 11.4.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.348, DATË 1.4.2008 TË KËSHILLIT
MIMINISTRAVE “PËR DHËNIE NDIHME TË MENJËHERSHME FINANCIARE
PUNËTORËVE TË FABRIKËS SË ÇMONTIMIT TË MUNICIONEVE NË GËRDEC BASHKIA
VORË, TË CILËT KANË NDËRPRERË PUNËN PËR SHKAK TË AKSIDENTIT
TEKNOLOGJIK, TË DATËS 15 MARS 2008”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 32 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

Pika 1 e vendimit nr.348, datë 1.4.2008 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon.
“1. Dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për çdo punëtor, i cili më 15 mars 2008, datë kur ndodhi aksidenti teknologjik, ka qenë i pranishëm në fabrikën e çmontimit të municioneve, në Gërdec.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha